



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 822 prot.

Ballsh më, 22. 02. 2023

VENDIM

Nr. 06, Datë 21 / 02 / 2023

PËR

**MIRATIMIN E DRAFT AKT MARRËVESHJES NDËRMJET BASHKISË
MALLAKASTËR DHE SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME
FIER SH.A. PËR VJELJEN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, shkresës me nr. 963/37 Prot., datë 18.05.2022 "Përcillet për njohje Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022", të VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Per politikat kombetare per riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe te largimit, trajtimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura", VKB nr. 46, datë 30.08.2022 "Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjetllës Kanalizimeve" Marrëveshjes së Bashkëpunimit për transferim aktiviteti nr. 1361 Rep., Nr. 619 Kol date 07.10.2022 ndermjet Sh.a Ujesjelles Kanalizime Mallakaster dhe Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Fier, Udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, VKB nr. 12, datë 24.02.2020 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak, VKB nr . 61 datë 24.11.2022 "Per Taksat dhe Tarifat Vendore per Vitin 2023"

VENDOSI

1. Miratimin e draft akt - marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Mallakastër dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a. për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore (taksë ndertese, tarifës së pastrimit, tarifës së gjelbërimit dhe tarifës së ndriçimit publik).
2. Ky vendim shoqërohet me draft akt – marrëveshjen.

KRYETAR

Fitim Baraj

